



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2019:082734

Datë: 10.01.2020

Numri i dokumentit: 00754124

P.nr.102/19

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, Gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. Z. M. nga fsh. Gj., per shkak të veprës penale vjedhje e sherbimeve nga neni 314 par. 1 të KP, e duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren PP.II.nr. 285-10/19 të dt. 25.03.2019, në seancën gjyqësore të mbajtur me dt.09.01.2020, në prezencë të PSH Shpend Binaj, të akuzuarit, muarr dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari F. M., nga i ati Z., e ëma N. e lindur R., i lindur me dt.01.10.1974, nga Gj., ku dhe tani jeton, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar baba i tre fëmijve, ka të mbaruar arsimin fillor, punëtor, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me dt. 10.10.2018 ne fsh. Gj. në shtepin e tij gjate kontrollit të bërë nga ekipa e kompanis KEDS me qëllim qe të perfitoi ne menyre te kundërligjshme nga shërbimet shfrytizon energjin elektrike ne menyre te pa autorizuar duke dëmtuar bllomben e majtë të njësorit nr. 452..... duke thyer kapakun e njësorit ne anën e djathtë permes se cilit ka futur në brendi shiritin filmik nga ana e majtë, me qëllim të pengimit te punës se diskut ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar saktë, me çrast ndërmarrjes KEDS i ka shkaktuar dem material.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhje e sherbimeve nga neni 314 par. 1 të KP.

Gjykata në kuptim të nenit 38,39,46,47,48,49,69,70 dhe 314 par. 1 të KP, të akuzuarit, ia shqipton:

DENIMIN ME KUSHT

Të akuzuarit F. M. duke ia vërtetuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej një viti, nga dita e plotëfuqishmeris së këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës KEDS në Prizren tia kompenzoji dëmin në shumën prej 101.02 €

Detyrohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ dhe në emër të takses për kompenzim të viktimave të krimit shumen prej 30 € të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmeris së aktgjykimit.

A r s y e t i m

PTH nga Prizreni me aktakuzën PP.II.nr. 285-10/19 të dt. 25.03.2019, ka akuzuar F. Z. M. nga fsh. Gj., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 i KP nr.04/L-082, aktakuzën në séances gjyqësore prej fillimit gjer në mbarimin e saj e ka përfaqësuar PSH Shpend Binaj, i cili ka bërë rikualifikimin e veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 në veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KP, pasi që kodi i ri është më i favorshëm për të akuzuarin ,në fjalen e fundit në tërsi ngel si në aktakuzë të ricilësuar, me kërkesë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar të mbajtur me dt.09.01.2020 dhe në vetë pranimin nga ana e të akuzuarit ka vërtetuar këte gjendje faktike:

Në tërsi është vërtetuar se me dt. 10.10.2018 në fsh. Gj. në shtëpin e tij gjate kontrollit të bërë nga ekipa e kompanis KEDS me qëllim që të perfitoi në menyrë të kundërligjshme nga shërbimet shfrytzojnë energjin elektrike në menyrë të pa autorizuar duke dëmtuar blloqin e majtë të njëisorit nr. 452..... duke thyer kapakun e njëisorit në anën e djathtë përmes se cilit ka futur në brendi shiritin filmik nga ana e majtë, me qëllim të pengimit të punës së diskutuar që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar saktë, me çrast ndërmarrjes KEDS i ka shkaktuar dem material.

Ketë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtim gjyqësor në mbrojtjen e tij vullnetarisht e ka pranuar fajsin .

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 259 të KPP, në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe poashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsis, pranimi i fajtit nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht në shqyrtimin gjyqësor, dhe pranimi është mbështetur në faktet e qështjes që përmban aktakuzën, siq janë, procesverbali mbi kontrollin nr. 085..... të dt. 10.10.2018, procesverbali i kalibrimin nr. .../19 të dt 29.11.2018, raporti i kalkulimit të shpenzimeve nr. 21.... të dt. 05.12.2018, fatura rikthimi i humbjeve DPZHP18..... të dt. 05.12.2018, fotodokumentacioni të cilat gjenden në shkresat e lëndës si provë materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH në Prizren.

Gjykata poashtu në tërsi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajsis në shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarit, është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248, nga se nuk egziston ndonjë nga arsyerat dhe kushtet për hüdhen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale nga neni 253 të KPP. Dhe nga këto fakte të cilat i përmban propozimi akuzues, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qënjes së veprës penale penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KP, gjithashtu në ketë drejtim shkon edhe fakti që i akuzuari ka pranuar fajsin në tërsi, gjykata ka vendosur të akuzuarin ta shpallë fajtor, dhe ia shqiptoi dënimin siq është cek në aktgjykim.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi denimin ka vlersuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KP, të cilat ndikojnë në lartësinë e denimit.

Gjykata si rrethanë letësuese pati parasyshë se i akuzuari ka patur qëndrim korrekt ndaj gjykatës, pranimin në tërësi të veprës së kryer, është penduar për veprën e kryer, ka shpreh gatshmeri të dëmtuarës t'ia kompenzoi dëmin, kurse rrethana posaqerisht rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasuroro juridike u muarrë në kuptim të nenit 463 par.2 të KPP-së pasi që fatura bashkangjitur shkresave të lëndës ishte bazë e sigurt për gjykimin e dëmit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 450 dhe 452 të KPP.

Vendimi me të cilin është i obliguar i akuzuari që të bëjë kompenzimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË
Departamenti i përgjithshëm
P.nr. 102/19 të dt. 09.01.2020

Sek. Juridike
F. Kabashi

G j y q t a r i
Robert Tunaj

UDHËZIME JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij, ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftushme për palët dhe gjykatën.